



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 82

Prishtinë, më 26.10.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selviye Halimi, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Agim Ademaj, Armend Zemaj, Pal Lekaj.

Munguan: Doruntinë Maloku, Valdete Bajrami dhe Milena Miliçević.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati, ZPRK; Kristian Ramaj, student; Ardian Bajraktari, MD; Eset Rama, MD; Sokol Begaj, SHKK; Dhurata Hoxha MD; Njomëza Zejnullahu, MD; Pranvera Musa, "Kosovapress"; Skënder Berisha, MD; Arton Konushevc, REL; Dritë Slivova, KTV; Egzonë Popova, BIRN; Dibran Istrefi, Klan Kosova; Albert Krasniqi, KDI; Naim Jakaj, Grupi VV; Egzon Pacolli, praktikant; Granit Berisha, praktikant; Sanije Berisha, OSBE; Blerta Bejtullahu, EUSR/EU office; Argjend Zejnaj, GP/AAK.

Nga stafi i Komisionit: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Raportim i ministres së Drejtësisë, znj. Dhurata Hoxha, lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Komisionit për Legjislacion të adresuara gjatë vitit 2015.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

Kryetarja ia dha fjalën ministres së Drejtësisë, znj. Dhurata Hoxha, që të përshkruajë përgjegjësitë dhe aktivitetet e ministrisë, sidomos tani si drejtuese e kësaj ministrie, që më pas anëtarët e Komisionit për Legjislacion, të parashtrojnë pyetjet apo shqetësimet në lidhje me sistemin e drejtësisë dhe pakon ligjore.

Dhurata Hoxha, tha se prioritetet që i ka prej momentit të marrjes së detyrës si ministre e Drejtësisë, do të ketë mundësi të realizohen deri në vitin 2018. Si prioritete, ajo përmendi edhe reformimin e disa ligjeve, për të cilat ka pasur kritika të shumta, p.sh. Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale, i cili shpejt do të kalojë në Qeveri dhe pastaj do të vijë edhe në Kuvend. Sipas znj. Hoxha, prioritet tjetër do të jetë edhe pakoja e reformimit të ligjeve, që do të jetë një proces gjithëpërfshirës, duke përmendur Ligjin për ndërmjetësim, Ligjin për noterinë, Ligjin e përmbarimit, që prekin anën komerciale, si dhe ndryshim-plotësimin e Ligjit për procedurën penale, Kodin Penal, që do të ketë parasysh të gjithë aktorët e sundimit të ligjit, proces që do të zgjasë dy vite.

Ministrja e Drejtësisë tha se ministria është e fokusuar në forcimin e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, ku me këtë synojmë të fuqizojmë parimin se të gjithë duhet të jenë të barabartë para ligjit. Znj. Hoxha, më pas shtoi se sa i përket nismës së Ligjit për amnisti, Gjykata Kushtetuese ka dhënë opinion se ligjet për amnisti nxirren kur ka konflikt, për t'i dhënë fund dhunës, si pjesë e një marrëveshjeje paqësore, në mënyrë që të promovohet pajtimi mes palëve të përfshira. Është e natyrshme që gjithmonë do të ketë kërkesa për amnisti, por pranimi i këtyre kërkesave nuk do të duhej të rezultojë në nisma ligjore, tha më tej ministrja Hoxha. Ndërsa, lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Komisionit për Legjislacion, të adresuara gjatë vitit 2015, ministrja e Drejtësisë tha se deri tani janë nënshkruar të gjitha rregullat e brendshme, përfshirë rendin shtëpiak në institucionet korrektuese, qendrave të paraburgimit, Burgun e Sigurisë së Lartë dhe qendrave korrektuese, dhe në kuadër të këtyre akteve, është rregulluar edhe mënyra e shfrytëzimit vjetor, duke pohuar se me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë, në programin legjislativ ka hyrë për ndryshim-plotësim Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale. Më tej, tha se ky ligj është hartuar dhe janë bërë ndryshimet e duhura, ku është përfshirë edhe rishikimi i dispozitave, sa i përket lirimit me kusht, duke përfshirë këtu përbërjen e panelit, si dhe mundësia e atakimit të vendimit të panelit. Tani pritet që të miratohet në Qeveri dhe pastaj të dërgohet në Kuvend, theksoi ndër të tjera ministrja Hoxha.

Ministrja potencoi se me hapjen e Burgut të Sigurisë së Lartë, në qendrat korrektuese janë vendosur të paraburgosurit që kanë qenë në Prishtinë, ku kapaciteti tani është i madh. Tani, shtoi ministrja Hoxha, është hyrë në fazën e hapjes së qendrave të tjera, ndër to edhe ajo afër Pallatit të Drejtësisë, me 300 shtretër. Më tej, shtoi se sa i përket kërkesave të faljes nga Presidenti, kurdo që të ketë gatishmëri nga Zyra e Presidentit, ministria është e gatshme të fillojë procedurat për shqyrtimin e kërkesave për falje nga Presidenti.

Shqetësim i ministres ishin kufizimet buxhetore, të cilat pamundësojnë një trajtim më të mirë në këto institucione. Ajo përmendi se me Kodin për drejtësinë për të mitur, është propozuar që paraburgimi për të mitur të ulet në 6 muaj.

Ne kemi kontrolle të rregullta në institucionet korrektuese. Kemi realizuar 1960 kontrolle në të gjitha institucionet, sipas legjislacionit në fuqi, theksoi ministrja Hoxha.

Po ashtu, ajo bëri të ditur se në programin legjislativ, pas pranimit të rekomandimit të Komisionit, me një punë intensive, janë përfshirë edhe plotësim-ndryshimi i ligjeve për KPK-në, KGJK-në dhe ZPD-në.

Pas prezantimit të ministres Hoxha, **kryetarja e Komisionit** kërkoi sqarime të shumta dhe komentoj për çështje të ndryshme, si për çështjen shqetësuese në raportet e ndryshme ndërkombëtare rreth pavarësisë së sistemit të drejtësisë, gjegjësisht kapjen e sistemit të drejtësisë, ku edhe përkundër deklarimeve publike, sistemi i drejtësisë dita-ditës vetëm po përkeqësohet. Në vazhdim, deputetja Haxhiu përmendi rastin e fundit, ku tha se drejtuesit e një grupi kriminal Nuhi Uka, i cili u shpall i pafajshëm nga Gjykata Themelore në Prizren. Më tej, znj Haxhiu theksoi se për këtë kapje të drejtësisë, përgjegjësinë kryesore e ka pasur edhe Ministria e Drejtësisë, në këtë rast ish- ministri, z. Hajredin Kuçi. Deputetja Haxhiu, për znj. Dhurata Hoxha parashtrroi pyetjen si vijon: A keni në plan propozimin e një projekti ligjor, i cili ka për qëllim çkapjen e sistemit të drejtësisë nga njerëz të politikës dhe një lloj vetingu moral që duhet t'i nënshtrohet i gjithë sistemi i drejtësisë, theksoi deputetja Haxhiu. Çështjet tjera, ku deputetja Haxhiu ngriti shqetësimet ishin edhe ato për draft-ligjet për Këshillin Gjyqësor dhe atë Prokurorial të Kosovës, si dhe atë për përgjithësitë disiplinore, vendosja e tij në Ministrinë e Drejtësisë, për çështjen e ZPD-së, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, vlerësimin paraprak të projektligjeve, në mënyrë që të mos vijnë shumë shpesh në plotësim-ndryshim Kodi Penal dhe i Procedurës Penale, parashkrimin për veprat korruptuese. Për Ligjin antimafia, znj. Haxhiu shtroi pyetjen se nëse është hequr dorë nga ky ligj, duhet të dihet edhe arsyeja pse është bërë një veprim i tillë. Në vazhdim, pyetjet kishin të bënin si vijon: shqyrtimi dhe amendamenti i Ligjit për deklarin e pasurisë gjyqtarëve dhe prokurorëve, pyetja tjetër kishte të bënte me draft-ligjin për konfliktin e interesit, ku kërkoi sqarim në lidhje me atë se çka parasheh i njëjti, edhe pse ende nuk është sjellë në Kuvendin e Kosovës, çështja e përmbaruesve privatë dhe vlerësimi i punës së noterëve, roli i Ministrisë së Drejtësisë në rritjen e buxhetit për sistemin e drejtësisë dhe mundësia e forcimit të këtij sistemi, nxjerrja e Ligjit për amnisti për qendrat korrektuese, suspendimi i zyrtarëve nga qendrat korrektuese, që ishte skandaloz nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, rastin Drenica, që duket si tendencë për të kriminalizuar luftën e Ushtrisë Çlirimtare dhe cili është raporti i Ministrisë së Drejtësisë me Gjykatën Speciale, ishin pyetjet e parashtruara nga kryetarja e Komisionit, znj. Albulena Haxhiu.

Pal Lekaj, kërkoi sqarime mbi sasinë e lëndëve të pazgjidhura, ku përmendi një numër (mbi dyqind mijë) dhe mënyrës sesi do të arrihet zgjidhja e tyre, duke mos iu bërë përkrahimi i tyre. Çështja e politizimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si do të mund të arrihet depolitizimi, si do të bëhet emërimi i gjyqtarëve në veri të vendit, me gjithë neglizhencën e shfaqur nga Ministria e Drejtësisë? Po ashtu, për rastin e drejtorit të policisë në Mitrovicë, z. Nehat Thaçi, çështja e legjislacionit-ligjeve, që shpesh bien ndesh mes vete, krijimi i harmonizimit të tyre, Gjykata për Kundërvajtje, arrestimet kundër Kushtetutës së Republikës së Kosovës e ligjeve dhe vlerësimi i ministres për arrestimet e luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Danush Ademi, paraqiti dy ankesa për ministren, njëra nga të burgosurit minoritet në burgun e Prizrenit, të cilët maltretoheshin aty nga vetë të burgosurit, dhe e dyta, të burgosurit në burgun e

Dubravës, të cilët vuajnë dënime për vepra të lehta dhe maltretohen nga të burgosurit të cilët vuajnë dënime shumëvjeçare.

Albulena Haxhiu, për të qartësuar këtë çështje, tha se i është parashtruar pyetja ministres së Drejtësisë për këtë çështje, duke u bazuar në informatën që komuniteti rom po keqtrajtohet psikikisht dhe fizikisht nga të burgosurit dhe gjithashtu nga gardianët.

Selvije Halimi, dha komente lidhur me çështje të ndryshme rreth sistemit të drejtësisë, ku shtoi se që të kemi një sistem të mirë dhe efikas, duhet një punë e përbashkët në këtë drejtim. Pra, që të bëhet depolitizimi i sistemit të drejtësisë, duhet të kemi ligje që duhet të zbatohen, ashtu siç janë, pa pasur mundësi të interpretimit ndryshe nga kushdo qoftë, theksoi deputetja Halimi. Në vazhdim, tha se vendosja në sistemin e drejtësisë, pa argumente dhe në mënyrë jotransparente, po shkakton dëme të mëdha në gjithë shoqërinë, ku këtë e ndërliði me rastin Drenica. Sistemi i drejtësisë duhet ta ketë prioritet, qoftë drejtësia e EULEX-it ose ajo vendore, që mbi bazën e fakteve dhe provave të dëshmuara dhe të argumentuara dhe në mënyrë transparente, të marrë vendime, potencoi deputetja Halimi. Më tej, znj. Halimi dha premtimin për përkrahje në një reformim të thellë të sistemit të drejtësisë. Ajo përmendi edhe pakon ligjore, ku tha se duhet të harmonizohet me standardet e BE-së.

Armend Zemaj, tha se zbatimi i ligjit për sanksione penale është me interes. Këtu përmendi edhe vizitat që Komisioni kishte në burgjet e Kosovës, ku është parë nga afër implementimi i ligjit, por edhe kushtet dhe menaxhimi i burgjeve. Ngriti si shqetësim që të reflektojë mbi punën e ministrisë, që të mos nisen procedura ad-hoc, pa vlerësime adekuate të situatave të caktuara, për çfarëdolloj ligji. Në vazhdim, pyeti: kjo ministri, a ka ndonjë objektiv të qartë se ku do të arrihet përmes ndryshimeve të legjislacionit dhe cilat janë mangësitë që kjo ministri ka evidentuar? A ka ndonjë analizë të saktë ligjore? Sipas tij, kjo edhe është arsyeja që si komision kemi futur në monitorim Ligjin për Këshillin Gjyqësor dhe atë Prokurorial, si ligje të një rëndësie të veçantë. Po ashtu, tha se sa i përket pakos së ndryshimeve ligjore, përfshirë këtu edhe Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, ku është punuar shumë gjatë në këto dy kode, duhet pasur kujdes, sepse ka pasur ndryshime ligjore, ku për një periudhë të shkurtër është dashur prape t'i nënshtrohen ndryshimeve. Deputeti Zemaj ngriti si çështje jo vetëm të drejtat e të burgosurve, mirëpo edhe të punëtorëve që punojnë në qendrat korrektuese në Kosovë, që duhet të kenë mbështetje ligjore dhe buxhetore, e mbi të gjitha, siguri që të kryejnë punën dhe detyrën, kur dihet se me çfarë përballen ata njerëz. Z. Zemaj ngriti si shqetësim edhe qasjen e ofrimit të shërbimeve shëndetësore brenda qendrave korrektuese dhe kërkoi përgjigje sa i përket transferimit të burgosurve me dënime të larta në Burgun e Sigurisë së Lartë. Më tej, deputeti Zemaj shtoi se gjatë monitorimit të ligjit nëpër institucione të drejtësisë, ka pasur shumë dilema mes trupave që udhëheqin në këto institucione. Mes tjerash, ai përmendi dilemat në zbatimin e ligjit, përkrahjen ligjore, mënyrën e raportimit, performancës, grumbullimi i lëndëve etj. Në fund, z. Zemaj theksoi se pas përfundimit të mbikëqyrjes, do të ketë një qëndrim nga Komisioni se çfarë kaheje do t'i jepet ecjes dhe avancimit të sistemit të drejtësisë në vend.

Në të gjitha këto çështje të ngritura, ministrja Hoxha dha sqarimet përkatëse.

Znj. Dhurata Hoxha, lidhur me pyetjet për politizimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, tha se pavarësia e tyre citohet edhe me Kushtetutë, dhe si ministre, do të punojë në avancimin e kësaj pasurie, ndërsa për vendimet e gjykatës nuk kishte komente, mirëpo puna si ministre do ta bëjë të angazhohet në sundimin e ligjit për të gjithë njësoj dhe jo drejtësi selektive. Procesi i sektorit të

sundimit të ligjit, proces për të cilin ministria është e përkushtuar që të bëjë reformat dhe t'ua kthejë besimin e qytetarëve në drejtësi. Kodi Penal dhe i Procedurës Penale, edhe pse kanë hyrë në fuqi, kërkohen që të plotësohen dhe ndryshohen, për shkak të vërejtjeve nga gjyqtarët dhe prokurorët. Ligji antimafia, ligj i cili do të rregullohet në kuadër të dispozitave të Kodit Penal, për shkak se nëse hartohet si ligj i veçantë, do të ketë vështirësi në implementimin e tij. Po ashtu, dha sqarime edhe për Ligjin për konflikt interesi, i cili është tërhequr, me kërkesë nga BE-ja. Ligjet për përmbaruesit privatë, që presin miratim nga Kuvendi, janë ligje që janë plotësuar, ndryshuar duke marrë parasysh kërkesat e noterëve dhe të përmbaruesve. Komisioni për Noterinë është duke punuar në drejtim të evidentimit të parregullsive, përfshirë këtu ankesat e shumta. Ministria, gjithashtu, paraqiti shqetësimin për buxhetin e ndarë për këtë ministri. Znj Hoxha paraqiti edhe planet konkrete për këtë mandat, si Ligjin për ndërmjetësimin. Sa i përket suspendimit të zyrtarëve, ministria tha se ishte bërë, bazuar në nenet e rregulloreve dhe gjithnjë në zbatim të ligjit. Për rastin e Nehat Thaçit, ministria tha se ka marrë të gjitha masat si ministre, brenda kompetencave, për të vazhduar me gjykimin, pa dashur të ndërhyjë në drejtësi. Ndërsa, ZPD-ja në kuadër të ministrisë, për shkak të mosgarantimit të një pavarësie të plotë.

Kryetarja, tha se në takim me prokurorin e Zyrës Disiplinore, nuk ishin në pajtim me vendosjen e ZPD-së në ministri. Gjithashtu, Këshilli Gjyqësor dhe ai Prokurorial kishin qëndrime të njëjta, ku tha se do të ishte mirë që kjo zyrë të largohet nga Pallati i Drejtësisë, por në asnjë mënyrë të sille të Kuvend drafti, në të cilin thuhet se Zyra e Prokurorit Disiplinor të jetë në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, ku mes tjerash, tha se nuk do të ishte mirë që Komisioni për Legjislacion të përkrahë një nismë të tillë. Në vazhdim, deputetja Haxhiu kërkoi përgjigje në pyetjen se si e kanë paraparë, si ministri, mosparashikimin e veprave korruptive dhe ata të cilët kanë të ngritura aktakuza për raste korruptive, të mos jenë të përfshirë në asnjë institucion. Gjithashtu, pyetja e radhës ishte edhe për Gjykatën Speciale.

Ministria dha sqarime lidhur me këto shqetësime që u ngritën. Për luftimin e korrupsionit, tha se do të ketë reflektim të shpejtë mbi veprat korruptive, por theksoi se duhet pasur kujdes, duke ditur se jemi palë e shumë konventave ndërkombëtare dhe të gjitha ligjet duhet të harmonizohen me legjislacionin e BE-së. Po ashtu, tha se do ta mbështesë çdo iniciativë që do ta luftojë krimin e organizuar. Si Ministri e Drejtësisë, tha se nuk kanë obligim dhe nuk mund të interferojnë në punën e Gjykatës Speciale, vetëm se do të mund të kërkojnë transparencë.

Armend Zemaj, paraqiti shqetësim për ZPD-në, duke marrë parasysh punën e kësaj zyre në vendet evropiane, dhe si të tillë, i sugjeroi për ministres që për këtë zyrë të vendosë nga shembuj të ndryshëm nga vendet e Evropës, sepse është shumë me rëndësi që Kosova të ketë një zyrë të ZPD-së, të fuqishme dhe të pavarur, theksoi deputeti Armend Zemaj.

Pal Lekaj, citoi edhe njëherë për vendimet antikushtetuese të Gjykatës për Kundërvajtje, si dhe për burgjet e Kosovës, ku të miturit dhe të dënuarit për krime të rënda janë në të njëjtën qeli.

Ministria Hoxha, tha se sa i përket Gjykatës për Kundërvajtje, janë duke i shqyrtuar të gjitha ankesat dhe së shpejti dalin me një zgjidhje. Sa i përket burgjeve, edhe për këtë çështje mendohet të gjendet një zgjidhje, brenda këtij viti.

Po ashtu, ministria foli për projektet dhe angazhimet e ministrisë në evidentimin e pakënaqësive, si në qendrat korrektuese, ashtu edhe në të gjitha lëmit ku kjo ministri është përgjegjëse, duke ngritur edhe njëherë çështjen e buxhetit të vogël të ministrisë. Lidhur me pyetjen e kryetares, ministria dha sqarime edhe për kompetencat e Ministrisë së Drejtësisë në veri të vendit, të cilat

deri vonë kanë qenë shumë të kufizuara, por gjithnjë e më shumë po bëhen më kompetentë në këtë pjesë të vendit.

Sokol Zogaj, tha se asnjëherë nuk ka pasur ndonjë ankesë nga komuniteti rom, ku shtoi se kjo çështje do të shqyrtohet me një kujdes të veçantë. Gjithashtu, tha se do të bëhet një hetim që pastaj të ketë informata më të sakta, në lidhje me këtë çështje. Ndërsa, sa i përket mbipopullimit me të burgosur, tha se me hapjen e Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë këtë vit dhe asaj në Gjilan, kjo çështje do të rregullohet. Z. Zogaj, në vazhdim, tha se do të hapet edhe Qendra për të Mitur në Lipjan, e që do të jetë shembull unik. Ndërsa, për spitalet, tha se në bashkëpunim me drejtorin e QKUKS-së, ku janë mundësuar katër dhoma, që të vendosen të burgosurit, barnat e të burgosurve janë të siguruara nga vetë institucioni, ndërsa transferimi i të burgosurve, ata të cilët janë mbi 15 vite, të burgosurit me rrezikshmëri të lartë dhe të burgosurit nga diaspora, nuk do të jenë më në burgun e Dubravës, por do të transferohen në Burgun e Sigurisë së Lartë, me shpresë se do të kemi buxhet shtesë, sepse ka mungesë të stafit, theksoi z. Zogaj.

Kryetarja, tha se shpejt do të realizohet edhe një vizitë, duke ditur se edhe të burgosurit dhe stafi ballafaqohen me kushte të rënda, ku të burgosurit duhet të mbajnë dënimet për veprat e bëra, por duhet të trajtohen në përputhje me konventat evropiane. Deputetja Haxhiu kërkoi përgjigje nga znj. Hoxha, në lidhje me funksionalizimin e gjykatave në tërë territorin e Kosovës, me theks të veçantë, të gjykatave në veri. Ajo shtoi se Kryeministri pati nënshkruar një marrëveshje për drejtësinë, që është kundërshtuar nga Lëvizja Vetëvendosje, duke ditur që ishte një marrëveshje etnike dhe e cila nuk ka pasur për qëllim shtrirjen e sistemit të drejtësisë në tërë territorin e Kosovës, ku kërkoi të dijë se cili është roli i ministrisë në procesin e rekrutimit të gjyqtarëve, kur dihet se ekziston tendenca e përfshirjes së njerëzve, të cilët kanë qenë pjesëmarrës, ndoshta në gjenocidin që është bërë në Kosovë.

Dhurata Hoxha, theksoi se në këtë çështje, MD-ja ka rol shumë të kufizuar, ndërsa sa i përket integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në veri, ministria ka organizuar provimin e jurisprudencës, dhe në bazë të ligjeve dhe Kushtetutës së Kosovës, gjithë dokumentacioni është dorëzuar dhe të gjithë kandidatët i kanë përmbushur kushtet. Pra, deri këtu, Ministria e Drejtësisë ka pasur kompetencë në këtë çështje, tha në fund znj. Dhurata Hoxha.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu